



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
NËNKOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21.2.2023

Nr: 22

URDHËR

PËR

SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NGA PAJISJET E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK,
PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022

Në mbështetje të nenit 14, nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, dhe nenit 178, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 14, datë 22.12.2011, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për përpunimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik të publikut”, si dhe në zbatim të vendimit nr. 44, datë 08.02.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e procedurave operacionale për shkatërrimin e të dhënave në Pajisjen Elektronike të Identifikimit (PEI) dhe Sistemin Elektronik të Identifikimit të Votuesve (SEIV)”

URDHËROJMË:

1. Asgjësimin e të dhënave të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Durrës, Dibër, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 Mars 2022.
2. Asgjësimi të kryhet në përputhje me procedurat operacionale të miratuara me vendimin nr. 44, datë 08.02.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhëri.

Data: 21.2.2023 Nr: 22



“Për shkatërrimin e të dhënave të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Ilirjan CELIBASHI